REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I12-2 Prot. **Tiranë 27/08 /2025**
Nr. Dok. 202500020/2

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientet e Komisariatit të Policisë nr. 2 Tiranë.*

Drejtuar: **Drejtues Madhor z. Ilir PRODA**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit
TIRANË

Drejtues i parë z. Elton ALUSHI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë
TIRANË

Komisariatit të Policisë nr.2 Tiranë
TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë më datë 15.01.2025.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (**MKPT**), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *"Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë.

Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.82 /2024[1] "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"* dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë".* si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e një viti më parë[2]. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, të referuara në vijim:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të cilëve ju është privuar liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisariatit të Policisë nr.2 Tiranë z. Ritvan Pali, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, Shefi i Komisariatit raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me masat e marra për përmirësimin e ambientit të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, të gjitha zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Në Komisaritin nr.2 Tiranë kryenin funksionin e OPGJ-së 12 specialistë policie, që merren me hetimin e rasteve të veprave penale të rënda dhe njëkohësisht kryenin veprimet procedurale të marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të arrestuar apo të ndaluar. Nga inspektimi i zyrave të punës të OPGJ-ve, nuk u gjetën sende apo mjete që ekspozojnë dhunë te personat e shoqëruar gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje të tyre. Ndërkohë provat materiale të paketuara gjendeshin në korridore dhe zyrat e punonjësve të policisë gjyqësore dhe jo në një ambient magazine më vete, kjo problematikë vjen në kundërshtim me nenin 214 të K.PR.Penale.

[1] Ligji i ri nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit", i cili ka hyrë në fuqi në datë 23.08.2024.
[2]Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I9-2 prot, datë 13.05.2024. Kthim përgjigje nr.5007/1/1Prot, Tiranë 24.06.2024.

Nga informacioni i drejtuesit të komisariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** për mbylljen e dhomave të sigurisë, pasi përgjatë inspektimit u konstatua se këto dhoma nuk ishin dyllosur dhe mbyllur sipas procedurës ligjore, gjithashtu ky komisariat nuk kishte asnjë dokumentacion vendimmarrës për këtë qëllim.

2. **Nuk ishin marrë masat** për plotësimin me korrektësi të "Procesverbaleve të Shoqërimit", në të gjitha rubrikat e tij.

3. **Nuk ishin marrë masat** për krijimin e dhomave për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.

4. **Nuk ishin marrë masat** për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit.

5. **Nuk ishin marrë masat** për krijimin e dhomave të përshtatshme për depozitimin e provave materiale, të cilat duhet të administrohen dhe ruhen në ambiente/dhoma të ndara për këtë qëllim sipas rregullave e procedurave standarde.

6. **Nuk ishin marrë masat** për pajisjen e Komisariatit nr. 2 Tiranë me monitorin për këqyrjen e pamjeve të dhomave të shoqërimit.

7. **Nuk ishin marrë masat** për ndërtimin e tualeteve të ndara më vete për gra dhe burra, sipas parashikimeve në procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.

8. **Nuk ishin marrë masat** për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

9. **Nuk ishin marrë masat** për pajisjen e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë me të drejtat e personave të shoqëruar dhe heqjen e posterave që tregojnë të drejtat e personave të arrestuar.

Ishin marrë masat për:

1. Në ambientet e komisariatit ishte afishuar lista ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, nga personat e shoqëruar ose ndaluar/arrestuar në këtë komisariat.

2. Ishin marrë masa për mirëmbajtjen e tualetit garantimin e kushteve higjieno-sanitare të tualetit si dhe ishin vendosur llambat e ndriçimit në këtë ambient.

3. Ishin marrë masat, për heqjen e skarave të hekurit në korridorin e dhomave të shoqërimit.

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e thellë se nuk ka asnjë angazhim nga Drejtuesit e Strukturave të Policisë së Shtetit për adresimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre, të cilat lidhen ngushtësisht me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurinë ligjore në rastet kur një individ ndodhet nën mbikëqyrjen e organeve të rendit. Personi i shoqëruar duhet të trajtohet me dinjitet dhe të ketë kushte të përshtatshme gjatë qëndrimit në komisariat (ngrohje, ujë, kushte sanitare).

Në përfundim të inspektimit, grupi i monitorimit konstatoi se, në ambientet e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Nr. 2 Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre,

Në Komisariatin e Policisë nr.2 Tiranë ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuara pjesërisht sipas kushteve dhe kritereve të mbajtjes dhe qëndrimit të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohen në procedurën standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit[3], ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit.[4]

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi për mbajtjen dhe qëndrimin e burrave, grave dhe të miturve në konflikt me ligjin. Dhomat e shoqërimit për burra dhe gra ishin me dimensione 4mx3m, ndërsa dhoma për shoqërimin e të miturve ishte 3mx3m, këto dhoma ishin të pajisura me nga një stol të palëvizshëm (të cilët ishin të dëmtuar) për qëndrimin ulur për personat e shoqëruar të rritur gjithashtu në këto dhoma mungonin tavolinat.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që lejonin mundësinë për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe dhomat kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë teli, për arsye të sigurisë së personave që ndodhen në këto ambiente. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje/ftohje.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë të veçantë për marrjen në pyetje/ intervistimin e shtetasve. Në çdo rast, intervistimi i personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Njëkohësisht edhe kryerja e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe komunikimi i masës së sigurisë të

[3] Kreu VI, pika 4 gërmat b dhe c "Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

[4] Pika 4 e procedurës standarde "Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë". e.1 Në njësitë vendore policore ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20 m² secila.

personave për kalimin nga dhomat e shoqërimit në dhomat e sigurisë, kryhej në zyrat e punës së punonjësve të policisë.

Një nga problematikat e evidentuara e cila është trajtuar edhe më herët nga Avokati i Popullit është mungesa **e dhomave të intervistimit/marrjes në pyetje të personit në cilësinë e të shoqëruarit, të arrestuarit apo të ndaluarit, brenda mjediseve të Policisë së Shtetit**.

a) Në komisariatet e policisë në Tiranë, ka mungesë të dhomave më vehte për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar që duhet të ndërtohen në këto mjedise;
b) Mungon instalimi i pajisjeve të sigurisë audio-vizive për të regjistruar procesin e marrjes në pyetje apo veprimeve të tjera procedurale hetimore me të shoqëruarit/arrestuarit/ndaluarit.

Në Procedurën Standarde të Punës "Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë", me Urdhërin: nr. 894, dt. 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohet qartë se: *Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme si*: i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).

i.1.1 **Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe këto kushte**:

Të ketë të instaluara tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj).

Tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohet, etj.

Instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vehte, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, nga punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre si nga ana e të shoqëruarve.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar[5] në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar.

Ndërkohë, vlerësojmë se në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda, si dhunime fizike, torturë apo të rasteve fatale të vdekjeve në ambientet e organeve të policisë, regjistrimi dhe ruajtja e filmimeve do të ishte një nga provat e rëndësishme për zbardhjen dhe identifikimin e autorëve të tyre. Me anën e regjistrimit audio-viziv mund të verifikohet dhe provohet nëse i arrestuari/ndaluari ka qenë ose jo i dhunuar para se të shoqërohej në organet e policisë, gjatë marrjes në pyetje para se të akomodohej në dhomat e sigurisë, apo është dhunuar brenda këtyre ambienteve, personat që e kanë takuar apo dhunuar, datën dhe orën e kryerjes së veprimeve të kundërligjshme, kryerjen e detyrave nga punonjësit e policisë të shërbimit të brendshëm, ofrimi i shërbimit mjekësor, etj. Për këto arsye, është domosdoshmëri monitorimi dhe ruajtja e regjistrimeve nëpërmjet të cilit do të mund të shmangen rastet e dhunës.

Dhomat dhe korridori në mjedisin e shoqërimit monitorohej nga sistemi i kamerave, Administrimi i kamerave kryhej nga specialistët e IT-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 30 ditë.

Ndërkohë përgjatë inspektimit konstatuam se në dhomën e oficerit të rojes, mungonte monitori për këqyrjen e pamjeve të dhomave të shoqërimit.

Në Komisariatin e Policisë nr.2 Tiranë **nuk kishte tualete të ndara më vehte për gra dhe burra** sipas sipas parashikimeve në procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022. Në këtë ambient ndodhej vetëm një tualet në korridorin ngjitur me dhomat e sigurisë, i cili paraqitej në kushte jo të mira higjienike dhe në të mungonte ndriçimi elektrik. Sa më sipër është në kundërshtim me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti, në të cilën përcaktohet se: e. Ambientet e dhomave të shoqërimit projektohen dhe ndërtohen sipas normave dhe parametrave teknikë dhe higjienikë të mëposhtëm:

e.1 Në njësitë vendore policore ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20 m² secila;

e.2 Pranë dhomave të shoqërimit dhe ngjitur me to ndërtohen dhe funksionojnë tualetet për kryerje të nevojave personale të ndara për gra dhe burra, me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6 – 8 m^2.

[5] *Rekomandohet krijimi i ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit. Nr.K4/I89-2 Prot, Dat. 28.12.2023.*

Nga inspektimi në tërësi i ambienteve të mjedisit të shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprime ndaj punonjësve të policisë.

Grupi i inspektimit konstatoi se 2 (dy) ambiente sigurie në këtë komisariat nuk ishin të mbyllur dhe dyllosur sipas parashikimit në procedurën standarde. Sipas informacionit të drejtuesit të komisariatit, dhomat e sigurisë janë të mbyllura me çelës dhe nuk përdoren më dhe sa i përket personave të arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në "Bllokun e dhomave të sigurisë" Tiranë, në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. **Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, ka ngritur shqetësimin e vazhdueshëm për mbylljen e dhomave të sigurisë dhe dyllosjen e tyre në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë**, sipas procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*, miratuar me Urdhër 1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në kohën e inspektimit, në mjediset e policisë së këtij komisariati nuk kishte persona të shoqëruar. Ndërsa prej muajit Janar 2025, në regjistër ishin evidentuar të dhënat për **105** persona të shoqëruar në mjediset e këtij komisariati, ku saktësisht ishin shoqëruar **98** shtetas madhorë, **6** shtetase gra dhe **1** shtetas të mitur.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre,

Në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë nuk kishte më ambiente të sigurisë funksionale dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat "Blloku i Sigurisë", ambient i cili është i ndërtuar sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", dhe procedurën standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*, miratuar me Urdhër nr. 1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**.**

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit, grupi i inspektimit konstatoi, se Komisariati i Policisë nr.2 Tiranë ishte i plotësuar me regjistrat e përcaktuar sipas procedurave standarde. Ato mbaheshin në zyrën e informacionit, si dhe administroheshin prej punonjësve të policisë të ngarkuar me këtë detyrë.

Konkretisht, në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë u konstatua se regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar" ishte i tipit "Model nr. 1", konform procedurave standarde *"Procedura Standarde e punës "Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë", miratuar me Urdhër: nr. 894 dt. 19.07. 2022* të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.82 /2024 "Për Policinë e Shtetit", regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 5 orë. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson uljen e kohës së ndalimit të përkohshëm, në Ligjin e ri për Policinë e Shtetit nr. 82/2024, i cili fillon që në momentin kur punonjësi ndalon personin dhe zgjat deri në sqarimin e çështjes, por në asnjë rast më shumë se 5 orë.

Ndërkohë, **përgjatë këqyrjes së këtij regjistri konstatuam se rubrika e regjistrit mbi njoftimin e familjarëve nuk ishte e plotësuar në mënyrë korrekte**, pasi në regjistër nuk ishte i shënuar emri i familjarit të njoftuar me numrin e telefonit përkatës, por ishte shënuar nga specialisti i policisë vetëm "njoftuar familjari" e cila nuk identifikon familjarin i cili ka marrë dijeni[6].

Në zyrën e informacionit të Komisariatit të Policisë nr.2 Tiranë ishte hapur një regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të personave të mitur të shoqëruar, në bazë dhe të rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim[7]. Për vitin 2025 ishin evidentuar të dhënat për 1 person të mitur.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkes/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, nuk rezultoi të kishte raste apo pretendime të evidentuara për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike, nga punonjësit e policisë të komisariatit.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë, nuk ka një dhomë më vehte të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale. Gjithashtu në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komiteti për Parandalimin e Torturër në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit[8]: Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë

[6] *Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë: dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre; sigurimin e aksesit te një avokati; njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin.*

[7] *Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 "Për garantimin e të drejtave të të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur".*

[8] Electronic recording of police interviews, fq,13, https://rm.coe.int/1680ae233b.

keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare.

KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre si dhe të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve nga vetë ata.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisariati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde[9]. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues te të miturit.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Përgjatë inspektimit në komisariatin e policisë nr. 2 Tiranë, u konstatua se kishte një listë të afishuar në ambientet e komisariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht. Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

KPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohet gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga

[9] Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: "I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur". I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë".

fillimi i heqjes së lirisë. KPT- ja gjatë vizitës në organet e Policisë së Shtetit ka konstatuar se: "Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar **për avokat** *kryesisht* vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t'i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati"[10]. Avokati i Popullit thekson se është e një rëndësie të veçantë afishimi në ambientin e shoqërimit të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i arrestuari/ndaluari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatë mbrojtës.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjithashtu përgjatë inspektimit dhe bisedës me Oficerët e Policisë gjyqësore konstatuam se **prania e psikologut nuk sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë** por ata kishin mundur të kontaktonin me psikologët e nismës për ndryshim shoqëror "ARSIS" të cilët përgjigjeshin vetëm pas orës 16.00, të çdo dite. Një problematikë kjo e konstatuar për të dytin vit rishtazi nga Institucioni i Avokatit të Popullit e cila ende nuk ka marrë zgjidhje.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë lajmëronin urgjencën dhe i shoqëronin ata në Qendrën Spitalore Universitare Nënë-Tereza Tiranë, për të marrë ndihmën mjekësore.

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë, grupi i inspektimit konstatoi se në dhomat e shoqërimit dhe në korridore, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, por konstatuam se në një nga dhomat ishin për personat e arrestuar dhe jo të shoqëruar. Theksojmë se, komisariati i policisë nr. 2 Tiranë nuk ka ambiente për trajtimin e personave të ndaluar arrestuar si dhe të drejtat e personave të arrestuar janë të ndryshme nga ato të personave të shoqëruar.

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit këqyri disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë nr.2 Tiranë, **u konstatua se disa nga "Procesverbalet e Shoqërimit", ishin të paplotësuara në të tëra rubrikat e tij.** Sa më sipër është një shkelje e rëndë e procedurave të punës, pasi është konstatim i përsëritur.

Në procedurën Standarde të punës *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përcaktohet qartë në kreun VII, pikat a.2.1 – Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit.

[10] https://rm.coe.int/1680ae233b, *fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.*

a.2.2 – Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet në dy kopje dhe pasi plotësohet sipas kërkesave dhe rubrikave të parashikuara në të, i dorëzohet punonjësit të shërbimit të informacionit, i cili e kontrollon për saktësinë dhe korrektësinë e plotësimit
a.2.3 – Nëse nga punonjësi i shërbimit të informacionit konstatohen parregullsi në plotësim ia kthen punonjësit të policisë për ta riplotësuar dhe njëkohësisht vë në dijen i eprorin e drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë.
a.2.4 – Një kopje e Formularit të Raportit të Shoqërimit i jepet punonjësit të policisë që ngarkohet për të sqaruar e trajtuar arsyen/shkakun e shoqërimit dhe zgjidhjen e çështjes për personin e shoqëruar dhe kopja tjetër administrohet nga punonjësi i shërbimit të informacionit, i cili në fund të çdo jave i dorëzon në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Gjithashtu, grupi inspektimit u informua se personat e shoqëruar/ndaluar njihen verbalisht me të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë, karta e të drejtave i jepet çdo personi të shoqëruar/ndaluar, që në momentin e hyrjes në ambientet e Komisariatit për të garantuar njohjen e të drejtave që nga fillimi i privimit të lirisë si një detyrim ky i cili i është ngarkuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës[11]. Ky veprim vjen në përputhje edhe me parashikimin në nenin 28 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*"; të nenit 21, germa "b" të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për nxjerrjen e përgjegjësive dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë të Komisariatit nr. 2 Tiranë të cilët **janë konstatuar nga Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur për të dytin vit rishtazi se kanë një neglizhencë të theksuar** lidhur me respektimin e të drejtave për personat e shoqëruar lidhur me:

    a) "Procesverbalet e Shoqërimit", të paplotësuara në rubrikat e tij.
    b) plotësimin me korrektësi rubrikën njoftimi i familjarëve tek Regjistri i personave të shoqëruar dhe evidentimi i tyre në këtë regjistër.

[11] KPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (d.m.th., që nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me ofrimin e informacionit të qartë verbal që në fillim, i cili do të plotësohet sa më parë (pra menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) duke siguruar Kartën e të Drejtave të sipërpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se kanë marrë një kopje të Kartës së të Drejtave.
Konsulto: https://rm.coe.int/168097986b

c) Mungesën e pranisë së psikologut në komisariat përgjatë intervistimit të të miturve.
d) Nuk është kryer dyllosja e 2 dhomave të sigurisë në këtë komisariat, sipas procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*, miratuar me urdhrin, nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomave për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë ambiente.

3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit.

4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave të përshtatshme për depozitimin e provave materiale, të cilat duhet të administrohen dhe ruhen në ambiente/dhoma të ndara për këtë qëllim sipas rregullave e procedurave standarde, dhe largimin e tyre nga korridoret e komisariatit dhe dhomave të punës të OPGJ.

5. Marrjen e masave për pajisjen e Komisariatit nr. 2 Tiranë me monitorin për këqyrjen e pamjeve të dhomave të shoqërimit.

6. Marrjen e masave për ndërtimin e tualeteve të ndara më vete për gra dhe burra sipas parashikimeve në procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. nr.894, datë 19.07.2022.

7. Marrjen e masave për plotësimin e dhomave të shoqërimit me stola dhe tavolina funksionale sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë".

8. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

9. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë me të drejtat e personave të shoqëruar dhe heqjen e posterave që tregojnë të drejtat e personave të arrestuar.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit **30 ditor** sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI

DV